

Arsimi dhe Formimi Profesional Shqiptar Programi Mbështetës

Konteksti

Shqipëria është një vend i vogël në perëndim të Ballkanit që kufizohet me Greqinë, Maqedoninë, Kosovën, Malin e zi dhe detet Adriatik e Jon. Ajo ka një popullsi prej rreth 3'700'000 banorësh. Rreth 1'000'000 shqiptarë jetojnë aktualisht si emigrantë jashtë kufijve, kryesisht në Greqi dhe Itali.

Ndërsa sistemi i arsimit të përgjithshëm i ka mbijetuar periudhës së tranzicionit dhe përballet tashmë me standardet europiane të cilësisë, arsimit dhe formimi profesional (AFP) ka nevojë për ri-ngritje nga e para.

Arsimi dhe formimi profesional ka potencial të madh për t'i dhënë shtytje ekonomisë dhe të kontribuojë në mënyrë të veçantë që njerëzit të hyjnë në tregun e punës. Në këtë mënyrë AFP kontribuon si në uljen e varfërisë, ashtu edhe në përshpejtimin e hapave drejt integritit europian.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i ka mbështetur projektet për arsim dhe formim profesional në Shqipëri që prej vitit 1994 dhe tani AlbVET përfaqëson brezin e tretë të projekteve.




Sistemi aktual i AFP qëndron mbi dy shtylla. Ai ofron programe shkollore 2 deri 4 vjeçare për nxënësit e shkollave të mesme dhe kurse formimi nga 1 deri 24 muaj për punëkërkuessit.

Sistemi i AFP-së përballet me sfida të vështira që përfshijnë:

- Vlerën dhe përshtatshmërinë ndaj tregut të punës,
- Aftësinë tërheqëse për nxënës potencialë,
- Cilësinë e ofrimit si për procesin e mësim-dhënies/nxënies, ashtu edhe përputhjen me standardet europiane të performancës profesionale,
- Pjesëmarrjen e sektorit privat në të gjitha nivelet që i përkasin hartimit të politikave, sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të trajnimit

Në bashkëpunim të ngushtë me donatorë dhe projekte të tjerë të mbështetur nga Bashkimi Europian, Gjermania dhe Austria, projekti AlbVET mbështet Qeverinë Shqiptare në reformimin e sistemit të AFP-së. AlbVET punon në të gjitha nivelet, d.m.th. me ofrues individualë, autoritetet vendore por edhe me qeverinë qendrore dhe institucionet e saj.



Agjencia financuese

SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Agjencia Zbatuese

Swisscontact

Fazat

Faza 1: 01.01.2007 – 30.06.2009

Faza 2: 01.07.2009 – 30.06.2011

Vëllimi Financiar

Faza 1: CHF 4'435'000

Faza 2: CHF 2'600'000

Partnerët vendas

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale

dhe Shanseve të Barabarta

Agjencia Kombëtare e AFP

Shërbimi Kombëtar i Punësimit

10 shkolla profesionale

Ofrues privatë të AFP

Shoqata biznesi

Zyra e projektit

1 Koordinator ndërkombëtar dhe këshilltar politikash

1 Menaxher projekti (vendas)

4 Koordinatorë komponentësh

1 Përgjegjës për marrëdhëniet me publikun

3 Nëpunës administrativ

Internet

www.albvet.al

Objektivat

Projekti AlbVET kontribuon në reformën e plotë të sistemit Shqiptar të AFP-së për ta transformuar atë në një sistem që i përgjigjet me efikasitet tregut të punës, që është tëheqës për pjesëmarrësit dhe që synon drejt standardeve europiane. Për t'i arritur këto, AlbVET-i zbaton katër komponentë. Përveç kësaj, parimet dhe përvojat e komponentëve integrohen në nivelin e politikë-bërësve qendrorë nëpërmjet një këshilltari të politikave.

Komponenti 1 – Reforma e sistemeve formale

Sistemi formal në nivelin e shkollës së mesme i është nënshtruar një reforme të thellë. Sistemi i ngurtë me programe 3 dhe 5 vjeçare po zëvendësohet me një sistem të ri fleksibël 2+1+1, me nivele të ndryshme specializimi dhe dalje për në tregun e punës. AlbVET mbështet zbatimin në dy drejtime profesionale me një paketë të plotë, që përfshin hartimin e kurrikulave, trajnimin e instruktorëve/mësuesve dhe pajisjet në shkollat profesionale në të gjithë vendin.

Komponenti 2 – Partneritet për të nxënë

Bashkëpunimi dhe partneriteti midis përfaqësuesve dhe aktorëve publikë e privatë, midis shkollave dhe bizneseve, thuajse nuk ekziston në Shqipëri. Raportet mes tyre janë të ndikuara nga një ndjenjë e thellë mosbesimi. Po ashtu, niveli organizativ i sektorit privat është ende i dobët. AlbVET synon të zhvillojë 4-6 modele lokale si partneritet për të nxënë,

Koncepti Programit AlbVET

Integrimi i komponenteve në një çati sistemike me një këshilltar në fushën e politikave dhe zhvillimin e kapacitetit për politikë-bërësit



duke zbatuar në një farë mënyrë skema duale apo çirakërie (trajnim nëpërmjet punës).

Komponenti 3 – Decentralizimi

Sistemi aktual shqiptar është shumë i centralizuar dhe i shpëputur nga tregu lokal i punës. AlbVET mbështet procesin e decentralizimit drejt vendim-marrësve vendorë, përmes pilotimit të një Qendre Rajonale gjysëm-autonome të Arsimit dhe Formimit Profesional në Qarkun e Durrësit.

Komponenti 4 – Përfshirja sociale

AFP-ja, si një mjet aktiv në funksion të tregut të punës është një instrument për përfshirjen në të të minoriteteve dhe grupeve të tjera në nevojë. Për këtë AlbVET mbështet zhvillimin dhe zbatimin e përqasjeve dhe koncepteve respektive.




AlbVET
Albanian VET Support Program

P.O.Box Nr.228, Rruga „Taulantia“
Durrës / Albania
Tel/Fax: +355 (0)52 224229
e-mail: albvet@swisscontact.al
www.albvet.al

Zbatuar nga:


swisscontact
Swiss Foundation for Technical Co-operation

Financuar nga:

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
**Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC**